

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndezi disa vatra zjarri në pyje dhe kullota në Himarë, arrestohet në flagrancë 52-vjeçari
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/ndezi-disa-vatra-zjarri-ne-pyje-dhe-kullota-ne-himare-arrestohet-ne-flag-i586193
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:43:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	af29961020db708f58ccad20a510a1f7e9da09ef0a378371592b1a83b1b1ea50
TEKSTI	70515556f6ece9539cea17f8ae98dc0e50f3f11f46775810c3a85d436d539e5d
PAMJA	c5b63847e5cd8427b689e93ff0f85fbd097892dd2c5d93d064a667b3a665622bc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	07e75e00e8c340916bca5c4330019b9cdfd996bc7ada7132497f20ad2d39fc5d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/07e75e00e8c340916bca5c4330019b9cdfd996bc7ada7132497f20ad2d39fc5d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1e [Himare/ Ndezi disa vatra zjarri ne kullota e pyje. Kapet ne flagrance 52-vjeçari \(VIDEO\)FOTO/ Nga Zendaya te Selena Gomez, yjet e Hollywood-it shkelqejne ne tapetin blu fundit](#)

Ndezi disa vatra zjarri në pyje dhe kullota në Himarë, arrestohet në flagrancë 52-vjeçari



15 Shtator 2026, 11:15Kronika TEMA



Një 52-vjeçar është arrestuar në flagrancë në Borsh të Himarës, pasi dyshohet se ka ndezur disa vatra zjarri që përfshinë sipërfaqe me pyje dhe kullota.

Flakët u përhapën në zonë dhe rrezikuan edhe një banesë, ndërsa ndërhyrja e forcave të Policisë dhe zjarrfikësve bëri të mundur vënien nën kontroll të situatës. Ngjarja po hetohet për zbardhjen e plotë të rrethanave.

Kapet në flagrancë pranë vatrave të zjarrit që dyshohet se ndezi, vihet në pranga 52-vjeçari. Nga zjarri u dogjën sipërfaqe me pyje e kullota dhe u rrezikua një banesë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Himarë, pas njoftimit se në Borsh kishte rënë zjarr dhe po digjeshin sipërfaqe me pyje dhe kullota, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje, në mbështetje të forcave zjarrfikëse, si dhe për kryerjen e veprimeve hetimore për zbardhjen e rrethanave të rastit.

Pranë vatrave të zjarrit, shërbimet e Policisë kanë konstatuar shtetasin D. Z., 52 vjeç, banues në Borsh, i cili dyshohet se kishte ndezur disa vatra zjarri në zonë.

Si pasojë e përhapjes së flakëve janë djegur sipërfaqe me pyje dhe kullota, ndërsa është rrezikuar edhe një banesë që ndodhej pranë vatrave të zjarrit.

Në vijim të veprimeve procedurale, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Himarë arrestuan në flagrancë shtetasin D. Z., për veprën penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë apelon për të gjithë qytetarët që të mos ndezin zjarre për djegien e mbetjeve apo për qëllime të tjera, pasi përhapja e flakëve mund të sjellë pasojë të rënda për jetën, pronën dhe mjedisin.

Gjithashtu, fton qytetarët të denoncojnë në numrin 112 çdo rast zjarrvënije apo paligjshmërie tjetër, duke garantuar anonimat të plotë, reagim të menjëhershëm dhe të paanshëm.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Nga arratisjet spektakolare te dënimet me burgim të përjetshëm, si arriti Alket Rizai të merrte 16 leje për të dalë nga qelia](#)

10:05 Kronika

Dosja "Revanshi", GJKO jep vendimin për 7 të pandehurit, mes tyre Durim Bami

09:45 Kronika

["Vendimi i KLGJ dhe KLP, i turpshëm" / Pagat e magjistratëve, Spaho: Vendosin Qeveria dhe Kuvendi!](#)

08:25 Kronika / 2 komente

Makina e vjedhur digjet në tunel/ Vlorë, Policia në kërkim të personave që e braktisën

07:56 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.